

” AlbAudit ” Sh.P.K.

Komiteti Paraolimpik i Kosovës

Prishtinë

Raport i Auditorit të pavarur

Pasqyrat Financiare

31.12.2022

P Ë R M B A J T J A

Faqja

Raport i Auditorit të Pavarur.....	1-2
Të përgjithshme.....	3
Pasqyrat financiare.....	4-5
Shpalosjet e pasqyrave.....	6-9
Organizimi i brendshëm në OJQ dhe përfundimi.....	9

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të OJQ-së, "Komiteti Paraolimpik i Kosovës"

Opinionit i auditorit

Gjatë kryerjes së punës së auditimit kemi arritur në përfundim se pasqyrat financiare janë të lira nga keq pohimet eventuale materiale.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat shoqëruese paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicioneve financiare të organizatës joqeveritare "Komiteti Paraolimpik i Kosovës"- Prishtinë, të procedurave ligjore dhe aplikative për periudhën 01.01. deri më 31. Dhjetor 2022, si dhe rezultatet e operimeve të saj në pajtueshmëri me principet e kontabilitetit të cilat janë të aplikueshme në Kosovë.

Baza për dhënje të opinionit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga shoqëria në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Në sajë të natyrës së shënimeve të OJQ-"Komiteti Paraolimpik i Kosovës" ne patëm mundësi të bindemi lidhur në saktësinë dhe kompletimin e evidencave lidhur me rrjedhën e parasë dhe qarkullimin bankar, si dhe pasuritë e detyrimet tjera përmes evidencave dhe regjistrave të cilët mbështesin këto llogari. Politikat e OJQ "Komiteti Paraolimpik i Kosovës" janë në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.06/L- 43 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të organizatës në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethanë, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Përgjegjësia e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF- të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të gabimit apo mashtrimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësitë e organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se kur drejtimi synon ta likujdoj organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Të ngarkuarit me qeverisjen e organizatës janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Përgjegjësia e audituesit të pavarur

Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin e bërë. Objektivat tona gjatë auditimit janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshinë opinion tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoj gjithmonë një anomali materiale kur ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ndërmarrja "AlbAudit" Sh.P.K.

Remzi Jashari, Auditor Ligjor

Mars, 2023



1. Shënimet e përgjithshme lidhur me OJQ. "Komiteti Paraolimpik i Kosovës"

Organizata Joqeveritare "Komiteti Paraolimpik i Personave me Aftësi të Kufizuara të Kosovës" është regjistruar më datë 06.07.2020. me nr. 5113569-5, nr. fiskal 600747416 në harmoni me qëllimet e komitetit-organizatës, bazuar në kreun I, nenit 1 të ligjit Nr. 04/L-57 mbi lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare. Selia e organizatës është në Prishtinë. "Klubi Paraolimpik i Kosovës" është themeluar bazuar dhe në përputhje me nenin 26 të ligjit 04/L- 57 i zëvendësuar me ligjin 06/L-043.

Organizata ka statutin e vet të adoptuar dhe aprovuar nga organet kompetente bazuar në ligj. Në këtë dokument janë të përshkruara në mënyrë të qartë misioni, vizioni i organizatës si dhe organet drejtuese dhe ekzekutive të Organizatës Joqeveritare "Komiteti Paraolimpik i Kosovës". Organizata sipas statutit përbëhet dhe drejtohet nga këto organe: Kuvendi Bordi Drejtues, Kryetari i komitetit dhe Keshilli mbikqyres.

Nga aktiviteti i organeve një qasje i është kushtuar punës së kuvendit të komitetit i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e komitetit dhe mban takime të rregullta në harmoni me statutin. Nga ekzaminimi i procesverbaleve nga takimet e kuvendit mund të shihet një punë e cila përshkohet me dëshmi lidhur me vendimet e rëndësishme të organizatës.

Gjithashtu organizimi i brendshëm i stafit është rregulluar nëpër Departamente të caktuara të cilat janë të ngarkuar për zhvillimin, udhëheqjen dhe menaxhimin e aktiviteve të caktuara.

Përpilimin e pasqyrave financiare, OJQ- "Komiteti Paraolimpik i Kosovës" e bën në harmoni me nenin 18 pika 6.1, 6.2 dhe nenin 6.9 të ligjit 04/L- 57. Raporti financiar është pjesa e III-të e raportit vjetor të Organizatës.

Organizata drejtohet nga bordi i drejtorëve, ku përcaktohen dhe drejtohen politikat e organizatës në harmoni me rregullore e ligj.

Fokusi i misionit të OJQ "Komiteti Paraolimpik i Kosovës" është qenia njerëzore pa diskriminim fetar, etnik, social dhe racor duke vepruar në përputhje të plotë me statusin e organizatës. Gjatë periudhës e cila ishte objekt i auditimit, organizata joqeveritare "Komiteti Paraolimpik i Kosovës" me sukses zhvilloi një mori projektesh në lëmin e aktivitetit paraolimpik dhe aktivitetit rinor sportiv të personave me aftësi të kufizuara.

Organizata Joqeveritare "Komiteti Paraolimpik i Kosovës" aktivitetin saj financiar gjatë vitit 2022 ka zhvilluar përmes llogarise bankare në bankën " BKT Banka " me seli në Prishtinë dhe numër të llogarisë 1901003647031134. Nga shpalosja e qarkullimit bankar dhe ekzaminimit të ekstrakteve kemi konstatuar se "Komiteti Paraolimpik i Kosovës" ka mbajtur evidenca të mjaftueshme lidhur me qarkullimin e parasë dhe të gjitha ndryshimet i ka të regjistruara në evidencat e saj kontabël.

2. Pasqyrat Financiare

Bilanci i Gjendjes

	(EUR)
Më31.12 2022	
Asetet	
Paraja e gatshme dhe gjendja e arkës	0.86
Grantet e pranuar	
Mjetet themelore, paisjet	--
Stoqet	-
Gjithsej Asetet	0.86
Detyrimet dhe fondet	
Detyrimet ndaj dhuruesve	0.86
Shpenzimet e përlogaritura	-
Detyrmet tjera	-
Gjithsej Detyrimet	0.86
Fondet	
Fondet e pashpenzuara 01 Janar 2022	--
Shtohen: Fondet e njohura në vitin aktual	131,063.77
Zvogëlohen: Fondet (shpenzuara) në vitin aktual	(131,063.77)
Gjithsej fondet	--
Gjithsej fondet dhe detyrimet	0.86

Pasqyra e të Ardhurave

(EUR)

Mbyllja e vitit

31 Dhjetor 2022

Të Ardhurat	
Mjetet e pranuara, kontributet, grantet	131,063.77
Gjithsej të Ardhurat	131,063.77
Shpenzimet e (Projektit)	
Shpenzimet e Programit	(108,782.54)
Menagjimi dhe administrimi	(9,174.46)
Shpenzimet tjera	(13,106.37)
Gjithsej Shpenzimet	(131,063.77)
Neto mbetja/mungesa për periudhë	-- --

KOMITETI PARALIMPIK I KOSOVES
NJOMZA EMINI
PRESIDENT



Qëllimi i themelimit dhe veprimtaria e OJQ “Komitetit Paraolimpik i Kosovës”

Qëllimi i themelimit të komitetit paraolimpik është qëllim i ligjshëm sportiv, si dhe zhvillimi i sportit të personave me aftësi të kufizuara në Prishtinë dhe më gjërë në Republikën e Kosovës duke krijuar kushte për zbulimin dhe zhvillimin profesional të talentëve të rinj sportive me aftësi ndryshe në të gjitha grupmoshat dhe gjinitë.

Veprimtaria e komitetit është zhvillimi i sportit për persona me aftësi ndryshe në republikën e Kosovës duke marrur pjesë në garat sportive brenda dhe jashtë Kosovës. Të gjitha veprimtaritë e komitetit regjistrohen në Federatën e Sporteve të Kosovës. Komiteti Paraolimpik i Kosovës është i përcaktuar në këto aktivitete:

- Organizimin, studimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e sportistëve të rinj me aftësi ndryshe nga të dy gjinitë pa dallim feje, race, krahine apo ideje.
- Marrjen pjesë në të gjitha garat kombëtare dhe ndërkombëtare që organizohen nga Federatat e Sporteve me aftësi ndryshe të Kosovës apo Federatat Ndërkombëtare
- Organizimin e garave të ndryshme në sport
- Aktivitete tjera në kuadër të veprimtarisë.
- **Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikat e rëndësishme të kontabilitetit**

- Bazat e përgatitjes dhe prezantimit

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Kontabilitetit të cilat aplikohen në Kosovë. Pasqyrat financiare janë të prezantuara në Euro. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe përveç nëse ceket ndryshe, ato janë të njëjtat me politikat aplikuar në periudhën paraprake. Periudha raportuese e organizatës është 12 muaj duke mbaruar më 31 Dhjetor të secilit vit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në baza krahasuese nga viti paraprak.

- Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

a) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

a) Kontributet, ndihmat

Mjetet e pranuar janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Donacionet dhe Subvencionet do të pranohen.

Kontributet dhe donacionet e subvencionet janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Mjetet e pranuar të shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

b) Llogarite e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë njohur kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të shlyer shumën ekziston si rezultat i operacioneve të Organizatës. Ato janë paraqitur në kosto.

c) Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur atëherë kur kanë ndodhur

i) Tatimi ne fitim

Organizata është e liruar nga tatimi në fitim.

Pasqyrat financiare janë përgatitur me qëllim të raportimit bazuar në dispozita ligjore si dhe për nevoja të menaxhimit të organizatës, me qëllim të marrjes së informacioneve për zhvillimin e aktivitetit më efikas që lidhet me fondet e pranuar për realizimin e objektivave të organizatës. Këto pasqyra financiare përfshijnë të gjitha shpenzimet e krijuara, të cilat janë të financuara nga donatorët dhe dhuruesit të cilët tash janë partner të besueshëm të OJQ "Komiteti Paraolimpik i Kosoves" me seli në Prishtinë.

Projektet e OJQ "Komiteti Paraolimpik i Kosoves" të realizuara gjatë vitit 2022

Projekti kryesor i Organizatës Joqeveritare Komiteti Paraolimpik i kosoves gjatë periudhës janar- dhjetor 2022 ishte zhvillimi i aktivitetit sportiv për persona me aftësi ndryshe dhe zhvillimin e sportit në tërësi si dhe aktivitetet e të rinjëve në fushën e sportit.

Përmes zhvillimit të këtyre projekteve, organizata ka arritur të përcaktoj objektivat, qëllimet, zhvilloj aktivitete dhe realizoj synimet statutore dhe ligjore.

Gjatë aktivitetit tonë u fokusuam dhe analizuam këto projekte duke mos konstatuar parregullsi në implementimin e tyre.

Tabela 1. Mjetet e pranuar sipas donatorëve

<u>Emertimi i dhuruesit</u>	Përmbyllja e vitit
	31, Dhjetor 2022
	Shuma
Thesari i Kosoves	108,865.00
FLOIL LLC	6,170.41
NPCDP	4,780.00
Ambasada Franqeze	1,000.00
TEB- SH.A.	10,000.00
Tjera	60.00
<u>Gjithsej:</u>	<u>130,875.41</u>

Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet

Në gjendjen e datës 31 Dhjetor 2022 pasuritë e organizatës joqeveritare “Komitetit Paraolimpik te Kosoves” ishin mjetet monetare ne llogari bankare.

Nga ekzaminimet e kryera gjatë auditimit kemi konstatuar se kjo organizatë joqeveritare, pasi që evidencat i bazon në ligjin mbi asocimin ne organizata joqeveritare si dhe ne ligjet dhe rregullat fiskale të republikës së Kosovës. Bazuar në dispozitat e përmendura të ardhurat janë njohur me rastin e shpenzimit gjegjësisht me rastin e implementimit të projekteve të caktuara. Me rastin e pranimi të parasë, shkaku i statusit jo profitabil “Komiteti Paraolimpik i Kosoves” së pari ka njohur detyrimin ndaj dhuruesit (si e ardhur e pafituar) të cilin veprim e konsiderojmë të drejtë dhe në harmoi me dispozitat ligjore. Këto të ardhura janë fituar bazuar në projektet e përgatitura nga “Komiteti Paraolimpik i Kosoves”. Shpenzimet janë njohur atëherë kur kanë ndodhur, sipas parimit kohor. Në përgjithësi jemi të mendimit se njohja e të ardhurave dhe e shpenzimeve është bërë në harmoni me standarde dhe rregulla. Sa i përket mënyrës së përlllogaritjes dhe pagesës së të ardhurave individuale, nuk ka pasur ndonjë lëvizje pasiqë shifet se aktiviteti administrativ është kryer vullnetarisht.

Tabela 2. Paraja në fund të periudhës

Më 31 Dhjetor 2021

Llogaritë në Banka Lokale	
BKT– Bank	0.86
Paraja dhe ekuivalentët	0.86
Total paraaja	0.86

Organizimi i brendshëm dhe procedurat e “Komitetit Paraolimpik të Kosovës”

OJQ- “Komiteti Paraolimpik i Kosovës”, aktivitetin e vet financiar e ka zhvilluar bazuar në procedurat e brendshme financiare të cilat mbështeten në ligje dhe rregullore në fuqi të cilat aplikohen në Kosovë. Nga analiza dhe ekzaminimi i bërë procedurave në fjalë, ne kemi konstatuar se në këto procedura janë definuar detyrimet si dhe autorizimet e zyrtarëve të angazhuar me punë. Procedurat e brendshme të cilat janë aplikuar nga “Komiteti Paraolimpik i Kosovës” dhe janë rishikuar dhe aprovuar nga zyrtarët e organizatës, janë në harmoni të plotë me ligje dhe rregullore të Kosovës të cilat lidhen me funksionimin dhe lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, si ligji Nr.06/L- 043, ligji mbi sportin në Kosovë etj. Ndër procedurat të cilat aplikohen në organizatë janë procedurat e buxhetimit të bazuara në procedura dhe rregulla financiare. Nga dokumentacioni mund të vërehet se funksioni i krijimit të dokumentit financiar si dhe aprovimi dhe ekzekutimi janë ndarë, që është në përputhje me kërkesat e standardeve dhe procedurave të operimeve financiare. Gjithashtu qartë është përshkruar kufiri dhe niveli i përgjegjësi dhe autorizimeve në menaxhimin e financave, sipas nivelit dhe pozitës së zyrtarëve. Në realizimin e procedurave financiare dhe të rrjedhës së parasë mund të shihet lëvizja e dokumenteve financiare prej momentit të parashtrimit të kërkesës për mjete financiare deri në momentin e aprovimit për pagesë dhe shpenzimit definitiv të këtyre mjeteve.

Përpilimin e pasqyrave financiare, OJQ- “Komiteti Paraolimpik i Kosovës” e bënë në harmoni me nenin 18.1 të ligjit 06/L-043 respektivisht nenit 18 pika 6.1. 6.2. dhe 9. Raporti financiar është pjesa e III-të e raportit vjetor të organizatës në harmoni me nenin 18.3.3. të ligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Procedurat financiare dhe rrjedhën e dokumentacionit dhe të parasë e kemi ekzaminuar në tërësi dhe jemi bindur në mbylljen e ciklit financiar.

Përfundimi

Me kompetencë dhe siguri të arsyeshme mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me evidenca të arsyeshme dhe se ekziston një saktësi e mjaftueshme në evidenca dhe pasqyra financiare. Nuk kemi vërejtur ndonjë gabim të nivelit material, ndonjë mashtrim apo tentim mashtrimi. Gjatë sigurimit të dokumentacionit nuk kemi pasur ndonjë pengesë për ta bërë këtë. Shprehim respektin tonë ndaj personelit për asistencën e ofruar. Auditimin e kemi planifikuar, dhe programin e auditimit e kemi realizuar sipas dinamikës së paraparë.